RELACION SHPJEGUES
MBI RISHIKIMIN DHE SAKTËSIMIN E NDËRHYRJEVE TË PARASHIKUARA PËR RESTAURIMIN E MUREVE ANTIKE TË LISIT

1. Qëllimi i relacionit

Ky relacion hartohet në vijim të kërkesës për rishikimin e projektit të ndërhyrjes në muret antike të qytetit të Lisit, me qëllim saktësimin e metodologjisë së ndërhyrjes, të mënyrës së zbatimit të parimeve të anastilozës dhe të trajtimit të materialeve të akumuluara ndër vite në strukturën e murit. Në këtë kuadër, synohet të sqarohet se ndërhyrja e parashikuar nuk ka për qëllim ndryshimin e karakterit, tipologjisë apo konfigurimit origjinal të murit antik, por ruajtjen, stabilizimin dhe rikthimin sa më pranë gjendjes së tij historike, duke përdorur në mënyrë prioritare materialin autentik të mbetur në strukturë.
Ndërhyrja lidhet me një fragment të kufizuar të murit antik, me gjatësi rreth **10 m linearë**, gjerësi rreth **3.50 m** dhe lartësi të ruajtur deri në rreth **3.00 m**. Përmasat dhe shtrirja e ndërhyrjes do të përcaktohen përfundimisht në terren, në varësi të gjendjes reale të strukturës dhe të evidentimit të elementeve origjinale.

2. Të dhëna historike dhe konstruktive mbi muret antike të Lisit

Për hartimin e ndërhyrjes janë marrë në konsideratë të dhënat e botuara në literaturën arkeologjike dhe restauruese mbi qytetin antik të Lisit, veçanërisht punimet e Frano Prendit dhe Koço Zhekut të botuara në revistën "Monumentet", dokumentacioni i mëvonshëm teknik mbi muret antike, si dhe një eksperiencë e ngjashme gjatë zbatimit të ndërhyrjeve restauruese në vitin 2019 tek një fragment tjetër i Murit Antik Lezhë.
Sipas të dhënave të botuara në artikullin e Frano Prendit dhe Koço Zhekut, "Lisi në dritën e të dhënave të reja arkeologjike", botuar në revistën "Monumentet", nr. 2, 1971, muret rrethuese të qytetit janë ndërtuar me gurë gëlqerorë të nxjerrë nga shtresat shkëmbore të vetë kodrës. Gjurmët e pykave metalike të evidentuara mbi blloqe dëshmojnë për mënyrën e nxjerrjes dhe përpunimit të materialit.
Muret janë ngritur mbi themele të përbëra përgjithësisht nga një radhë gurësh me sipërfaqe mbështetëse relativisht të madhe dhe trashësi më të vogël se blloqet e muraturës. Në terrene me pjerrësi, themeli realizohet me shkallëzime, ndërsa në raste të tjera është shfrytëzuar edhe shkëmbi i gjallë, i cili është përgatitur me fole drejtkëndëshe për të siguruar qëndrueshmërinë dhe për të shmangur rrëshqitjen e muraturës.
Dy faqet e murit, e jashtme dhe e brendshme, janë realizuar me blloqe të mëdha guri. Sipërfaqet anësore të blloqeve janë përpunuar në mënyrë që të sigurohet mbështetja dhe puthitja e tyre, ndërsa faqet e dukshme kanë një përpunim karakteristik të tipit të gufuar/konveks. Hapësira ndërmjet dy pareteve është plotësuar me gurë të përmasave të ndryshme dhe, në veçanti, me çakëll të trashë të krijuar gjatë procesit të përpunimit të blloqeve.

Një element i rëndësishëm konstruktiv është edhe prania e lidhjeve tërthore ndërmjet dy pareteve të murit. Blloqe të gjata janë vendosur në drejtim tërthor me aksin e murit për të realizuar lidhjen e paretit të jashtëm dhe atij të brendshëm me bërthamën e muraturës.
Kjo mënyrë ndërtimi dëshmon se muri antik nuk është një masë homogjene dhe e mbushur rastësisht, por një strukturë e organizuar në **dy parete të jashtme dhe të brendshme, të lidhura konstruktivisht me një bërthamë mbushëse prej materiali guror**.
Sipas të dhënave të mëvonshme të botuara në "Monumentet", nr. 55, 2016, gurët e mureve antike janë nxjerrë nga gurore të hapura brenda territorit të banimit dhe janë përdorur gurë gëlqerorë me forma dhe përmasa të ndryshme. Në themele janë përdorur gurë të zgjedhur me sipërfaqe të madhe mbështetëse, ndërsa në bërthamën e murit janë përdorur materiale gurorë të përmasave të ndryshme.

3. Organizimi konstruktiv i murit dhe rëndësia e bërthamës

Nga analiza e teknikës së ndërtimit rezulton se bërthama e murit ka pasur një funksion të rëndësishëm në sistemin konstruktiv. Ajo nuk duhet konsideruar thjesht si material mbushës pa funksion, por si pjesë e sistemit të përgjithshëm të transmetimit dhe shpërndarjes së ngarkesave ndërmjet dy pareteve.
Në kushtet fillestare, bërthama ka qenë e përbërë kryesisht nga materiale gurorë, çakëll dhe gurë me përmasa të ndryshme, të vendosur në mënyrë të tillë që të krijohej një masë e qëndrueshme ndërmjet dy pareteve.
Për këtë arsye, çdo ndërhyrje në bërthamën e murit duhet të kryhet në mënyrë të kontrolluar dhe vetëm në masën që është e nevojshme për ruajtjen e strukturës dhe rikthimin e saj sa më pranë konfigurimit fillestar.

4. Gjendja aktuale e fragmentit ku parashikohet ndërhyrja

Muret antike të Lezhës, pavarësisht kohës së gjatë të kaluar nga ndërtimi i tyre, ruajnë në shumë pjesë një gjendje të mirë të materialit guror. Kjo lidhet me cilësinë e materialit, teknikën e ndërtimit dhe mënyrën e zgjedhjes dhe vendosjes së blloqeve.
Megjithatë, konfigurimi i murit nuk ruhet në mënyrë të plotë në të gjithë gjatësinë e tij. Në pjesë të ndryshme lartësia e ruajtur ndryshon dhe në disa segmente blloqet kanë rënë.
Në fragmentin ku është parashikuar ndërhyrja evidentohen blloqe antike të zhvendosura ose të rrëzuara, si dhe prani e konsiderueshme e vegjetacionit. Një problem i veçantë paraqitet nga materiali i akumuluar ndër vite në bërthamën e murit.
Si rezultat i proceseve natyrore, rrëshqitjeve, akumulimit të dherave dhe materialeve aluvionale, si dhe zhvillimit të bimësisë, një pjesë e hapësirës së bërthamës është mbushur me materiale të huaja për strukturën origjinale, kryesisht me dhera nga kodra.
Këto materiale, veçanërisht dherat dhe materialet argjilore, kanë sjellë ndryshim të karakteristikave fizike të bërthamës dhe, në disa raste, krijojnë presione mbi paretet anësore. Kjo gjendje ka ndikuar në zhvendosjen e disa blloqeve nga pozicioni i tyre fillestar dhe në humbjen e vazhdimësisë së muraturës.

5. Argumentimi i nevojës për heqjen e kontrolluar të dherave

Heqja e dherave të akumuluara në fragmentin e murit nuk parashikohet si një proces gërmimi masiv apo si ndryshim i konfigurimit arkeologjik të strukturës.

Qëllimi i këtij procesi është çlirimi i kontrolluar i strukturës nga materialet e huaja që janë grumbulluar ndër vite dhe që nuk përkojnë me tipologjinë e mbushjes së përdorur në ndërtimin origjinal të murit.

Në kushtet aktuale, bërthama e murit nuk paraqet në të gjitha pjesët karakteristikat e materialit fillestar guror të përshkruar në dokumentacionin arkeologjik. Prania e dherave, materialeve argjilore, aluvioneve dhe vegjetacionit ka zëvendësuar pjesërisht materialin guror të bërthamës dhe ka krijuar një situatë që nuk i përgjigjet mënyrës origjinale të ndërtimit.

Për këtë arsye, zbankimi i dherave do të kryhet vetëm aty ku vlerësohet teknikisht i nevojshëm, në mënyrë të kontrolluar dhe graduale, përgjatë fragmentit rreth 10 m të murit ku është parashikuar ndërhyrja.

Nuk parashikohet zbankim uniform dhe i pakushtëzuar i gjithë bërthamës së murit. Shtrirja dhe thellësia e heqjes së materialit do të përcaktohen në terren, pas evidentimit të gjendjes së secilit bllok dhe të lidhjeve konstruktive ndërmjet pareteve.

Në këtë mënyrë ndërhyrja respekton parimin e minimumit të ndërhyrjes, pasi hiqet vetëm materiali që është i nevojshëm për:

- evidentimin dhe lirimin e blloqeve antike hap pas hapi;
- kontrollin e gjendjes së paretit të jashtëm dhe të brendshëm,për aq sa lejohet pas heqjes të materialit në mbushjen e pareteve;
- mundësimin e rikthimit të blloqeve të rrëzuara në pozicion;
- eliminimin e materialeve të huaja që krijojnë presione të padëshiruara;
- rivendosjen e një mbushjeje të përshtatshme me karakteristika sa më pranë asaj origjinale.

6. Materiali i ri për bërthamën e murit

Pas heqjes së materialit të huaj dhe pas evidentimit të strukturës origjinale, mbushja nuk do të trajtohet si një element i ri i pavarur nga muri antik.

Synimi është rikthimi i karakterit konstruktiv të bërthamës, duke përdorur materiale të përshtatshme me tipologjinë e dokumentuar të muraturës antike.

Në këtë kuadër parashikohet përdorimi i materialeve gurorë, në mënyrë të kombinuar, ku përfshihen **çakëlli dhe gurët e vegjël/gurët e kavës me dimensione duke filluar nga 2-3 cm deri ne 15-20 cm**, sipas nevojës dhe në përputhje me materialin e evidentuar në strukturën ekzistuese.

Materiali i ri nuk synon të zëvendësojë blloqet origjinale apo të rindërtojë pjesë të humbura pa dëshmi. Ai do të përdoret vetëm si material mbushës i bërthamës, me qëllim stabilizimin dhe rikthimin e karakteristikave konstruktive të strukturës.

Në çdo rast do të ruhet dallimi ndërmjet materialit origjinal të mbetur dhe materialit plotësues, duke shmangur ndërhyrjet që mund të krijojnë një interpretim të rremë të pjesëve autentike të murit.

7. Metodologjia e anastilozës

Në vijim të kërkesës për respektimin e parimeve të anastilozës, ndërhyrja do të bazohet në ruajtjen dhe ripërdorimin e elementeve origjinale, për aq sa është e mundur, duke shmangur zëvendësimin e tyre me materiale të reja.

Blloqet antike të rrëzuara do të identifikohen, dokumentohen, numërzohen dhe do të rivendosen në pozicionin e tyre fillestar ose në pozicionin më të mundshëm të përcaktuar në bazë të gjurmëve dhe lidhjeve të tyre me muraturën ekzistuese.

Rivendosja do të kryhet në mënyrë graduale dhe të kontrolluar. Fillimisht do të identifikohet niveli i mbështetjes dhe pozicioni i blloqeve të ruajtura, më pas do të vendosen blloqet që mund të rikthehen në pozicion pa ndërhyrje të dhunshme mbi materialin autentik.

Në rastet kur një bllok nuk mund të vendoset me siguri në pozicionin fillestar, ai nuk do të detyrohet në një pozicion të hamendësuar, por do të trajtohet në mënyrë që të ruhet dhe të dokumentohet.

8. Rendi i punimeve

Për të shmangur krijimin e ngarkesave apo presioneve të padëshiruara mbi strukturën, punimet do të realizohen në mënyrë të shkallëzuar.

Në parim, procesi do të ndjekë këtë rend:

1. Dokumentimi fotografik, grafik dhe përshkrues i gjendjes ekzistuese.
2. Identifikimi dhe shënjimi i blloqeve origjinale që janë të rrëzuara ose të zhvendosura.
3. Pastrimi manual i vegjetacionit në zonën e ndërhyrjes.
4. Zbankimi i kontrolluar dhe selektiv i dherave dhe materialeve aluvionale vetëm në zonat ku ky proces është i nevojshëm për lirimin dhe stabilizimin e strukturës.
5. Evidentimi i mbështetjes së blloqeve dhe i lidhjeve konstruktive të murit.
6. Rivendosja e blloqeve origjinale të identifikuara, duke ndjekur sa më shumë të jetë e mundur pozicionin dhe rendin fillestar.
7. Plotësimi gradual i bërthamës me material guror të përshtatshëm, duke ruajtur tipologjinë e mbushjes së dokumentuar për murin antik.
8. Kontrolli i vazhdueshëm i stabilitetit të dy pareteve gjatë procesit të ndërhyrjes.
9. Pastrimi përfundimtar i zonës dhe eliminimi i vegjetacionit të dëmshëm.

Në rastet kur kërkohet çmontim i kufizuar i ndonjë blloku për të mundësuar rivendosjen e tij, kjo do të bëhet vetëm pas dokumentimit të pozicionit fillestar dhe vetëm në masën e domosdoshme.

9. Trajtimi i bërthamës dhe kontrolli i qëndrueshmërisë

Duke pasur parasysh gjerësinë e murit, rreth **3.50 m**, mbushja e bërthamës do të realizohet në mënyrë të kontrolluar dhe të njëtrajtshme, duke shmangur krijimin e përqendrimeve të materialit në njërën anë.

Në vendosjen e materialit në bërthamë do të merret në konsideratë pozicioni i qendrës së rëndesës së strukturës dhe shpërndarja sa më e balancuar e masës në të gjithë seksionin e murit.

Mbushja do të kryhet gradualisht, në koordinim me rivendosjen e rreshtave të blloqeve, në mënyrë që të mos krijohen shtytje të njëanshme mbi paretet.
Në këtë mënyrë, mbushja e re nuk trajtohet vetëm si proces plotësues, por si pjesë e masave për rikthimin e ekuilibrit konstruktiv të murit, duke respektuar teknikën tradicionale të ndërtimit dhe karakteristikat e materialit ekzistues.

10. Mbi eliminimin e gërmimit të përgjithshëm përgjatë gjithë perimetrit

Në përputhje me kërkesën për rishikimin e projektit dhe me parimet e ndërhyrjes minimale, sqarohet se nuk synohet kryerja e një gërmimi të vazhdueshëm dhe uniform përgjatë gjithë perimetrit të murit.
Zbankimi do të kufizohet në fragmentin ku ndërhyrja është e domosdoshme dhe, brenda këtij fragmenti, vetëm në zonat ku materiali i akumuluar pengon:

- evidentimin e blloqeve origjinale;
- vlerësimin e gjendjes së muraturës;
- lirimin e elementeve të zhvendosura;
- rikthimin e blloqeve në pozicion;
- dhe realizimin e një mbushjeje të përshtatshme të bërthamës.

Kjo mënyrë pune shmang ndërhyrjen e panevojshme në pjesët e paprekura të strukturës dhe përputhet me kërkesën që çdo veprim restaurues të kufizohet në atë që është teknikisht dhe konservueshmërisht i nevojshëm.

11. Përfundime

Nga analiza e dokumentacionit historik, arkeologjik dhe teknik rezulton se muret antike të Lezhës janë struktura të ndërtuara me një teknikë të organizuar murature të thatë, të përbërë nga dy parete me blloqe guri dhe një bërthamë mbushëse me material guror të përmasave të ndryshme.
Gjendja aktuale e fragmentit ku parashikohet ndërhyrja është ndikuar nga proceset natyrore dhe nga akumulimi ndër vite i dherave, materialeve aluvionale dhe vegjetacionit në bërthamën dhe në zonën përreth murit. Këto materiale nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht përbërjen origjinale të bërthamës dhe, në kushtet aktuale, mund të ndikojnë negativisht në stabilitetin e pareteve.
Për këtë arsye, **zbankimi i pjesshëm dhe i kontrolluar i dherave konsiderohet i nevojshëm vetëm në zonat ku evidentohen problematika dhe ku ky veprim është i domosdoshëm për çlirimin, dokumentimin dhe rivendosjen e blloqeve autentike**.
Pas heqjes së materialeve të huaja, bërthama do të plotësohet në mënyrë graduale me materiale gurorë, kryesisht çakëll dhe gurë të vegjël, duke respektuar tipologjinë e mbushjes së dokumentuar për muret antike të Lisit.
Në këtë mënyrë, ndërhyrja e rishikuar nuk synon një rindërtim të ri të murit, por **stabilizimin dhe rikthimin e një fragmenti ekzistues në një gjendje sa më pranë konfigurimit të tij të mëparshëm**, duke përdorur maksimalisht materialin origjinal dhe duke kufizuar ndërhyrjet e reja vetëm në ato që janë të nevojshme për konservimin e strukturës.

Ndërhyrja në fragmentin prej rreth 10 m linearë do të kryhet me faza, duke dokumentuar çdo hap dhe duke përshtatur shtrirjen e zbankimit me gjendjen reale të strukturës të evidentuar gjatë punimeve.

Në përfundim, metodologjia e propozuar konsiderohet në përputhje me kërkesën për respektimin e parimeve të anastilozës dhe të ndërhyrjes minimale, pasi prioriteti i saj është **ruajtja e strukturës ekzistuese, rikthimi i elementeve autentike dhe përdorimi i materialeve të reja vetëm si plotësim teknik i domosdoshëm dhe i dallueshëm nga materiali origjinal**.

Elson Laqja
Digitally signed by Elson Laqja
Date: 2026.09.02 13:20:11 +02'00'
Fatjon Mlloja
Digitally signed by Fatjon Mlloja
Date: 2026.09.02 13:34:49 +02'00'
Sabrina Kuci
Digitally signed by Sabrina Kuci
Date: 2026.09.02 14:22:07 +02'00'
Petrit Bilali
Digitally signed by Petrit Bilali
Date: 2026.09.02 15:10:57 +02'00'
Helidon Sokoli
Digitally signed by Helidon Sokoli
Date: 2026.09.02 15:18:17 +02'00'
Endri Haxhiu
Digitally signed by Endri Haxhiu
Date: 2026.09.29 13:41:18 +02'00'
Vulosur elektronikisht nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore
Date: 2026/09/29 13:42:17 +02'00'
d9a3088bc3d04d6daf69ad570dc4c1152026092913421601040
Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore)